

Për: **TEB Sh. A.**  
Zyra Qendrore  
Prishtinë



**NFK – Ndihmë Fëmijëve me Kancer**  
nr.R.OJQ **5110938-4**  
Nr.F. 600197695  
Prishtinë  
[www.NFK-ks.org](http://www.NFK-ks.org)

Lidhur me njohtimin tuaj për bllokim të llogarisë sonë deri në sjellje të dokumentacionit e kërkuar nga ana juaj

Prishtinë, 02 Nëntor 2015

Të nderuar,

OJQ “NFK – Ndihmë Fëmijëve me Kancer”, me seli në Prishtinë, është shoqatë e prindërve dhe familjarëve me fëmijë të prekur nga kanceri. Me punën tonë tërësisht volontere aktivitetet i kemi të përqëndruara në zhvillimin e mëtejshëm të shërbimit onkologjik pediatrik publik në Kosovë. Të gjitha mjetet që i mbledhim i dedikojmë për këto aktivitete.

Lidhur me njohtimin tuaj për bllokim të llogarisë sonë deri në sjellje të dokumentacionit e kërkuar nga ana juaj, mund t’ju informojmë si vijon (ose bashkangjitur gjeni dokumentet gjegjëse:

1. Certifikata e regjistrimit OJQ me Status të Beneficiar Publik.
2. Statuti i OJQ-së (ku janë të specifikuar aktiviteti dhe organet e OJQ-së).
3. Dokumentet valide të identifikimit të bashkë-themeluesëve dhe personit të autorizuar.
4. Dokumenti për verifikimin e adresës së OJQ-së.
5. Lista e projekteve të realizuar nga OJQ-ja: Mbledhja dhe drejtimi i donacioneve për nevoja të Repartit apo të pacientëve në Repart; (Flowcytometry, interneti, kompjuterat, reagjensat specifike, nxemset me rrymë nëpër dhoma, klima në laborator, ...)
6. Gjendja e kontos sonë ku lehtë mund të shihni që burimi i financimit të aktiviteteve tona janë donacionet simbolike dhe të rastit.
7. Deklarojmë që nuk kemi institucion/organizatë që na financon.
8. Deklarojmë që përfutuesit përfundimtar të mjeteve që i mbledhim janë reparti Onkologjik/Hematologjik Pediatrik pranë QKUK dhe fëmijët të prekur nga kanceri dhe familjet e tyre.
9. Projektet vijuese të planifikuara për t’u realizuar nga OJQ-ja janë:
  - Mirëmbajtja e ueb faqeve të NFK-së për
  - a) informim të familjarve, donatorëve dhe tjerëve të interesuar për aktivitetet e NFK-së;
  - b) publikim të raporteve financiare për sigurim të transparencës në mbledhjen dhe shpenzimin e mjeteve.
  - Mbulimi i shpenzimeve për dërgim në Austri të mostrave të gjakut për Flowcytometry për diagnostifikim të hershëm të Leukemisë në mungesë të kuadrove dhe reagjensave në QKUK për punim të kësaj analize edhe pse paisja është funksionale në Repart.
  - Për tejkallim të mangësive sporadike në organizim të shërbimit gjegjës brenda QKUK-së, do të angazhojmë kompani profesionale për mirëmbajtje të paisjes FACSCALIBUR për Flowcytometry dhe paisjeve TI të repartit Onkologjik pediatrik.
  - Do të angazhohemi edhe më tej në përparim të mirëqenjes së pacientëve (siguria, higjiena dhe komforti) si dhe në përparimin dhe lehtësimin e punës së stafit të Repartit.

Ilir Gorani  
drejtor ekzekutiv  
NFK – Ndihmë Fëmijëve me Kancer  
044/049 120322  
[iliri@nfk-ks.org](mailto:iliri@nfk-ks.org)

